

KONTRATE SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(Lloji kuota)

Sot me date **08.11.2024** ne palet e meposhtme redaktojme kete kontrate si me poshte vijon:

PALA shitese:

1. **Z. Kei Arian Çala**, me nr ID : J60420089C, datelindje 20.04.1996 qytetar Shqiptar, me vendlindje ne Elbasan dhe banim ne lagj: Shenkoll, rr: Fetah Cankja, Elbasan 3001, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, ne cilesine e ortakut qe i korrespondon 50% te kapitalit te shoqërisë.

PALA blerese:

- **Z.Ergi Luan Shkëlqimi**, me nr ID : J70521065L, datëlindje 21.05.1997 qytetar Shqiptar, me vendlindje në Elbasan dhe banim në: lagj. 28 Nentori, rr: Lublin Dilja, Elbasan 3001.

Të përgjithshme

1. Shitesi është zotërues i 50(pesedhjetë) kuotave, me vlere 500 000 (*peseqind mije*)Lek, qe perben **50(pesedhjetë)** % te kapitalit të Shoqërisë "TURTLES" shpk, me seli ne TIRANE, Rruga "Perlat Rexhepi" , Zona Kadastrale 8270, vol.90, faqe 135, numer pasurie 4/194-N 1/1. (më poshtë referuar si shoqëria.)
2. Shoqëria është rregjistruar pranë QKB-se si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e pajisur me **NUIS M42307021R** me objekt kryesor "Piceri, Catering, BarKafe, Delivery .".
3. Kapitali i shoqërisë është 1 000 000 (*njemilion*) lek.
4. Shoqëria " TURTLES " Sh.p.k zotërohet nga dy ortakë:
 - a. **Z.KEI ÇALA**, i cili zoteron 1 kuota qe perbejne 50% te kapitalit themeltar me vlere 500.000 leke.
 - b. **Z.ERGI SHKËLQIMI**,i cili zotëron 1 kuota qe perbejne 50% te kapitalit themeltar me vlere 500.000 leke.

Neni 1

Objekti

Në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontrate, Shitesi i kalon bleresit 1(nje) kuote, me perqindje 1 % të kapitalit të zotëruar në kete shoqëri si dhe të drejtat e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje duke e garantuar plotësisht per titullin e pronësisë.

Neni 2

Çmimi

Çmimi i shitjes eshte caktuar sa vlere nominale e tij ne vleren prej 10 000 (dhjete mijë) Lek, vlerë e cila do të likujdohet në llogarinë bankare të shitësit.

Neni 3

Kalimi i pronësisë mbi kuotat

Kalimi i pronësisë mbi kuotaen do të kryhet menjëherë me nënshkrimin e kontratës.

Neni 4 Garancitë

Shitesit në lidhje me kuotën që zotëron, garanton bleresin se :

1. Është pronar i vetëm i kuotes.
 2. Në të njëjtën kohë garanton dhe siguron palën blerese se sot në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate kuota është e lire nga çdo barrë, marrëveshje apo vendim tjetër kufizues;
- Nuk është objekt i ndonjë konflikti gjyqësor;
 - Është e lire nga çdo e drejtë apo pretendim i personave të tretë;

Neni 5 Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga Ligji "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" si dhe dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

Neni 6 Regjistrimi

- Kjo kontratë duhet të regjistrohet pranë QKB-së në bazë të nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.
- Pas nënshkrimit të kësaj kontrate shoqëria "TURTLES" Sh.p.k do të ketë po 2 ortakë:
Z. KEI ÇALA, zotërues i kuotes që përfaqëson 49 % të kapitalit të Shoqërisë në vlerën 490.000 leke.
Z. ERGI SHKËLQIMI, zotërues i kuotes që përfaqëson 51% të kapitalit të Shoqërisë në vlerë 510.000 leke.
- Personi që kalon kuotat dhe ai që i fiton ato, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave, nga Çasti i kalimit të kuotave deri në Çastin e regjistrimit të kalimit sipas dispozitave në fuqi.

Neni 7 Shpenzimet

Të gjitha taksat, tatimet si dhe shpenzimet që kanë lidhje me këtë kontratë do të paguhet nga pala përkatëse sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar. Palët në këtë kontratë nuk mund të kërkojnë njëra tjetrës uljen/ngritjen e çmimit të shitjes për shkak të shpenzimeve të sipërpëmendura.

Neni 8 Interpretimi i Kontratës

Çdo kusht apo formulim që mund të shkaktojë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët në lidhjen e kësaj kontrate.

Për çfarë nuk është parashikuar në këtë kontratë, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 9 Njoftimi zyrtar midis palëve

Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim ndërmje palëve do të bëhet në formë të shkruar dhe në adresat e përshkruara në këtë kontratë.



Neni 10

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi apo zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, do të zgjidhet me bisedim dhe mirëkuptim të ndërsjellë midis palëve dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jete *Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane*.

Neni 11

Hartimi i Kontratës


Kjo kontratë hartohet në kater njësi origjinale të cilat kanë të njëjtën përmbajtje dhe vlerë ligjore, prej të cilave nga 3 njësi i mbajnë palët dhe një njësi depozitohet pranë QKB-së .

Ne Palët deklarojme se kuptojme dhe se e pranojnë këtë kontratë, pasi ajo është në përputhje me vullnetin tone të lirë dhe të plotë dhe e nënshkruajmë atë rregullisht.

PALËT KONTRAKTUESE

**BLERESI
ERGI SHKËLQIM**

Ergi Shkëlqimi



**SHITESI
KEI ÇALA**

KEI ÇALA

